



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

N/B: 70318  
16.01.19

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES / PRONONCIJA  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE



PSH.nr. 703/18

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Eurofamis" Sh.a. - Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: "Noti Beton & Noti Construiction"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" – Prishtinë", me numër të prokurimit: 616-18-6909-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më datë: 27.12.2018, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Eurofamis" Sh.a. - Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" – Prishtinë", me numër të prokurimit: 616-18-6909-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.

**II. ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" – Prishtinë", me numër të prokurimit: 616-18-6909-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Eurofamis" Sh.a. - Suharekë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 17.09.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 10.10.2018, ku kanë marrë pjesë dy (2) operator ekonomik.

Njoftimi për kontratë është bërë me dt: 07.11.2018

Kundër njoftimit për dhënien e kontratës operatoret ekonomik: "Eurofamis" Sh.a. - Suharekë, me dt: 16.11.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 22.11.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: "Eurofamis" Sh.a. - Suharekë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: "Eurofamis" Sh.a. - Suharekë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 30 Nëntor 2018, me nr. 703/18, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" – Prishtinë", me numër të prokurimit: 616-18-6909-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim pikat 9.1 dhe 9.2, Aneksi 5.

Organit Shqyrta i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.12.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtaues, për të shqyrtauar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtaues në raportin e dt: 12.12.2018, ka sqaruar se është i pa qëndrueshëm pretendimi i OE ankues për arsy se të dy anëtaret e konzorciumit kanë Deklaratë nen Betim të vulosur dhe të nënshkruar në baze së cilës zotohen se janë të përshtatshëm në përmarrë pjesë në aktivitetin e prokurimit në përpjekje me nenin 65 të LPP-së. Ajo qe potencohet në pretendim ankimor është jo relevante për tu plotësuar pasi që në Deklaratën nen Betim identifikohet operatori ekonomik, adresa, emri i përfaqësuesi nënshkrim data dhe vula.

Eksperti shqyrtues ka sqaruar pretendimit ankimore nr. 2 nuk është plotësuar formulari i Identifikimit Financiar nga Grupi i Operatorëve ekonomik sipas Ekspertit ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse mos nënshkrimi i tij nuk paraqet shkelje ligjor sepse nuk është obligativ për tu plotësuar. Identifikimi financiar mbetet në vullnetin e operatorit ekonomik për tu plotësuar dhe asnë nga rregullat e prokurimit publik nuk kërkojnë që identifikimi financiar të plotësohet por edhe sikur të jetë e nevojshme për tu plotësuar AK, duhet ta vendos në dosje të tenderit .

Eksperti shqyrtues ka sqaruar pretendimi ankimore nr. 3 që ka të bëj me përvojën e inxhinierit të ndërtimtarisë OE ankuas, ka pjesërisht të drejtë , por nëse i referohemi kërkesave të dosjes dhe dokumenteve të këruara në FDT si dëshmi të dokumentuara lidhur me kërkesat kualifikues që kërkohen për aftësitë teknike dhe profesionale janë këruar Kontratat e Punës dhe CV-të, dhe nëse marrim për bazë CV-në e inxhinierëve të ndërtimtarisë (inxh. Fatmir Tolplica dhe Xhavit Dakaj ) lidhur me përvojën e punës një kërkesë e tillë plotësohet nga OE i rekomanduar për kontratë.

Eksperti shqyrtues ka sqaruar pretendimin nr. 4, Lidhur me shkeljen ku konstaton se OE i rekomanduar ofron liste të pajisjeve që ka në pronësi dhe njëkohësisht ofron liste të pajisjeve qe i merr në shfrytëzim nga OE” Integral” dhe për këtë ekzistojnë marrëveshjet parapake. OE i rekomandua për kontratë nuk e ka plotësuar listën standarde në dosje të tenderit por ka hartuar liste të pajisjeve në te cilën përshkruhen pajisjet sipas llojit dhe tipit të pajisjes dhe njëkohësisht si dëshmi për pajisjet janë të bashkangjitura , faturat , librezat e qarkullimit dhe DUD-at.

Sipas këtij pretendimi kontrata me furnizim me zhavor ndërmjet Operatorëve Ekonomik “Noti Beton ” & Mineral L.L.C” nuk është e nënshkruar nga “Noti Beton ” me konkretisht lidhur me këtë pretendim ankimore eksperti konstaton se marrëveshja ne mes, “Mineral LLC” dhe “Noti Beton ” përmban vulën dhe datën por nuk përmban nënshkrimin, Sipas Ekspertit Shqyrtues në kuptim të nenit 72 AK mund te kërkoj sqarime shtese lidhur me marrëveshje përfurnizime me zhavor pasi qe veç ekziston një marrëveshje paraprake.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimin nr 6, është i pa qëndrueshëm pasi qe sipas pretendimeve paramasa nuk është e nënshkruar siç duhet nga operatoret Ekonomik qe përben Konzorciumin. Lidhur me këtë pretendim ankimore Eksperti konstaton se formulari i tenderit , deklarata e tenderuesve dhe tabela e përshkrimit të çmimeve janë të nënshkruara , dhe rregullat ligjor për prokurim publik nuk kërkojnë që paramasat të jenë të nënshkruar fletë përfletë ashtu siç pretendohet në ankesë.

Gjithashtu sipas Ekspertit Shqyrtues pretendim nr. 7 është i paqëndrueshëm sepse në dosje të tenderi nuk është këruar plani dinamik. AK në dosje ka këruar që afati maksimal për realizimi të punimeve duhet te

jetë 90 ditë, që nënkupton se kjo kërkesë është kusht i kontratës i cili paraprakisht është saktësuar ne dosje të tenderit dhe i takon kushteve të veçanta të kontratës e jo kritereve administrative apo kritereve të përgjedhjes.

Eksperti Shqyrtues vlerëson se aktivitetit të prokurimi me titull "Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik mbrapa sheshit "Zahir Pajaziti" – nga komisioni vlerësues është vlerësuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë, dhe sipas konstatimeve të mësipërme nuk kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave ligjore të LPP-së, por me disa lëshime që mund të konsiderohen si devijime të vogla që nuk ndikojnë ne rezultatin përfundimtar të vlerësimit.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, kriteret e parashtuar në dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontratë, Eksperti Shqyrtues konstaton se ankesa e OE ankues "Eurofamise " është pjesërisht e bazuar por si rezultat i konstatimeve të lartë theksuara Eksperti Shqyrtues përkrah vendimin Autoritetit Kontraktues pasi që OE i rekomanduar ofron çmim me të lirë dhe plotëson kërkesat e dosjes me disa lëshime të vogla që nuk mund të ndijojnë në vlerësimin final.

Autoriteti Kontraktues – KK-Prishtinë, me datë: 12.12.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 27.12.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbal i mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Bytyqi deklaroj: Ne deklarojmë se qëndrojmë pran pretendimeve tona ankimore si me poshtë: Ne ofertën e OE të shpallur fitues ne kemi gjetur mjafte dëshmi qe nuk është i përgjegjshëm nga ana administrative. Siç edhe e kemi cekur edhe ne ankesë edhe kemi ofruar dëshmi ne FTD sipas AK-së, është kërkuar vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve neni 27 ekzaminimi i tenderëve pika 27.1 tenderët e pranuar me kohe do te ekzaminohen vlerësohen dhe krahasohen ne baze të procedurave të përcaktuara ne rregulloren e Prokurimit publik 27.2 tenderi konsiderohet të jete i përgjegjshëm a) Kërkesë ne FDT qe OE duhet te ofroj listën sipas aneksit 5 ndërsa OE i rekomanduar nuk e

ka nënshkruar dhe plotësuar pra aneksi 5 ka qene i obliguar për tu plotësuar, kjo është kërkesë e domosdoshme nga AK. Te gjithë OE kane forma te veta lista te pajisjeve por ne këtë rast nga AK qe OE duhet te përdorin formën e përpiluar nga AK dhe është shkelje ligjore ky ndryshim, kemi pika tjera dhe të FTD nuk është plotësuar si duhet kemi disa vërejtje te nënshkrimi dhe vulosja dhe është shkelje administrative, gjithashtu kemi piken furnizimi me zhavor ne baze të FTD-së, nuk është nënshkruar por vetëm vulosur, lëshime të tilla te bëra nga OE janë te patejkalueshme ku këtë gjë e pohon edhe eksperti dhe këtë e konsiderojmë si dëme ndaj kompanisë tone si nga ana administrative dhe financiare dhe me gjithë këto shkelje ligjore të shpërblehet një OE është e papërgjegjshme si procedure pasi qe është i papërgjegjshme nga ana administrative dhe financiare dhe deklarojmë se qëndrojmë pran pretendimeve ankimore dhe kërkojmë të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Sallahu deklaroj: Ne si AK mendojmë qe kemi vepruar drejtë ne marrjen e vendimit përfundim si të pabazuar të KR nga OE ankues. Arsyet i mbështesim pasi qe OE i rekomanduar i ka përbushur te gjitha kushtet dhe kriteret po ndalna ne piken 5 të cilën OE ankuese e kontestoj OE i rekomanduar ka sjellë listën ne forme te Exelit por ka qen ne Word, po ashtu po ndalem te pika tjetër plotësimin e formularit te FTD ku grapi i OE ka nënshkruar FTD ku edhe me tepër lideri i grupit ka nënshkruar si dhe përfund ne praktikat e mëhershme te cilat i kemi ndjekur ne OSHP dhe po ashtu ne si AK kemi pranuar listën e makinerive ne forme te radhitura duke u bazuar ne një forme të veçante dhe pajtohem i me vendimin e ekspertit dhe kërkojmë qe vendimi i AK te mbetet ne fuqi

Gjatë prezantimit në seance eksperti shqyrtues z. Sheqiri deklaroj: Nuk kam shume përfundim qe kemi vepruar drejtë ne marrjen e vendimit përfundim si të pabazuar të KR nga OE ankues. Arsyet i mbështesim pasi qe OE i rekomanduar i ka përbushur te gjitha kushtet dhe kriteret po ndalna ne piken 5 të cilën OE ankuese e kontestoj OE i rekomanduar ka sjellë listën ne forme te Exelit por ka qen ne Word, po ashtu po ndalem te pika tjetër plotësimin e formularit te FTD ku grapi i OE ka nënshkruar FTD ku edhe me tepër lideri i grupit ka nënshkruar si dhe përfund ne praktikat e mëhershme te cilat i kemi ndjekur ne OSHP dhe po ashtu ne si AK kemi pranuar listën e makinerive ne forme te radhitura duke u bazuar ne një forme të veçante dhe pajtohem i me vendimin e ekspertit dhe kërkojmë qe vendimi i AK te mbetet ne fuqi

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshtjeve të provave në tërësi gjatë seancës përfundim kryesor, konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht

obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ti verifikoje dhe të kërkojë scharime shtesë për të gjitha dëshmitë-dokumentet dhe referencat (e OE-së, grupit të operatorëve ekonomik të rekomanduar për konratë), të cilat i konteston operatori ekonomik ankues, më saktësisht të vërtetojë kontratat në mes konzorciumit a përbajnë të gjitha nënshkrimet dhe kërkesën mbi mundësitet teknike dhe/ose profesionale tek pika 4. Gurëthyes i licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr (agregat) të vërtetoj se a është e nënshkruar marrëveshja në mes anëtarëve të konzorciumit për furnizim me zhavorr.

Paneli shqyrtues scharon se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues scharon se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

#### Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Komuna e Prishtinës
- 1x1 OE - "Eurofamis" Sh.a. - Suharekë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web-faqe të OSHP-së.